



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2025/0049**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Isa Hasani, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “AWA” SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Paisje Rekuizita Sportive” me numër të prokurimit; 616-24-11629-1-2-1, me 07/04/2025, mori:

### **Vendim**

1. Refuzohet si e pa bazuar, ankesa e operatorit ekonomik OE “AWA” SH.P.K. me nr. 2025/0049, e datës 16/01/2025, kundër vendimit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Paisje Rekuizita Sportive” me numër të prokurimit numër: 616-24-11629-1-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues AK/Komuna e Prishtinës.
2. Mbetet në fuqi, B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, i datës 24.12.2024, AK/ Komuna e Prishtinës, për aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën 1.(një) të vendimit.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Arsyetim**

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Komuna e Prishtinës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 11.11.2024 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Paisje Rekuizita

Sportive” me numër të prokurimit 616-24-11629-1-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 22,679.00 €

AK me datën 24.12.2024 ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës operatorit ekonomik “Europrint”

OE “AWA” SHPK me datën 06.01.2025 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës. AK me datën 09.01.2025 ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim te OE.

Kundër vendimit të cituar si më sipër me datën 16.01.2025 operatori ekonomik “AWA SH.P.K.” ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2025/0049 (Nr. protokolli).

Në fazën e shqyrtimit paraprak:

(a) OSHP ka konstatuar se ankesa në rastin konkret është ushtruar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, sikurse parashihet me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë ankuesi ka statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, që do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet në kuptim të dispozitave të cituara dhe bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e OSHP. Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP-së.

(b) Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me këtë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar. Lidhur me këtë, me 29.01.2025 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit rekomandime të cilat përshkruhen si në vijim:

- Ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar,
- Të mbetet në fuqi vendimi i AK-së

*Përgjigje e Autoritetit Kontraktues në pretendimet ankimore të OE “AWA SH.P.K.”*

Lidhur me pretendimin ankimor ku thuhet se tenderuesi i rekomanduar nuk ka përmbushur kërkesën e DT për kontratat e realizuara në 3 vitet e fundit para publikimit të njoftimit për kontratë, është gjetur se kërkesa e DT është formuluar si vijon: 3.Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës se njëjta apo të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) jo me pak se 30.000.00€; Dëshmia 3. Një listë në origjinal të kontratave të përfunduara për furnizim të ngjashme të

realizuara në periudhën e shkuar tri vjeçare. Lista duhet të jetë afërsisht e njëjtë me Aneksin Nr. 7. duke saktësuar furnizimet e përfshira, shumën e kontratës, datën e pranuesit; (i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër apo partner biznesi, për dëshmi të këtij livrimi shërbejnë kopje të certifikatave (certifikata, raporte pranimi, referenca) të rëndësishme të lëshuara ose të bashkë-nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur shërbimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i furnizimit të tillë. Tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar listën me kontratat e realizuara në 3 vitet e fundit ku vetëm njëra kontratë është mbi 60 mijë euro. Pra dukshëm është përmbushur kërkesa e DT. Pretendimi është i pabazuar. Lidhur me pretendimin ankimor ku thuhet se tenderuesi i rekomanduar nuk ka përmbushur kërkesën e DT lidhur me katalogun e prodhuesit, është gjetur se kërkesa e DT është formuluar si vijon: 4. Operatori ekonomik duhet të ofrojë Katalog nga prodhuesi në harmoni me specifikimet teknike të përcaktuara në Aneksin 1 të dosjes së tenderit Katalogu nga prodhuesi për të gjithë artikujt e specifikuar në aneksin 1 të dosjes së tenderit.

Në rastin konkret është gjetur se tenderuesi i rekomanduar e ka dorëzuar katalogun nga një prodhues për artikujt e kërkuar sipas dosjes së tenderit. Pretendimi është pa bazë. Lidhur me pretendimin ankimor ku thuhet se tenderuesi i rekomanduar ka prezantuar si lider Arbonra Zabeli Aliu BI në deklaratën për themelimin e GOE ndërsa në e prokurim ka prezantuar si lider OE Europrint shpk. Me këtë rast është gjetur se edhe me deklaratën për themelimin e GOE por edhe me rastin e lidhjes së ofertës përmes e prokurimit si lider dhe person kontaktues është përcaktuar Arbnora Zabeli Aliu BI. Prandaj pretendimi është i pabazuar.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi, Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

*Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "AWA SH.P.K." në ankesën Nr. 0049/2025 janë parashtruar si në vijim:*

AK/Komisioni vlerësues gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 përkatësisht dispozitat ligjore të lartcekura dhe Udhëzimin operativ për prokurim publik. AK/zyra e prokurimit me 26.12. ka nxjerre njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe ka rekomanduar për kontratë grupin e OE: Europrint Group sh.p.k. & Arbnora Zabeli Aliu. Me 26.12. kemi dërguar kërkesë për qasje në dokumente zyrtare dhe AK me 27.12 na ka ofruar qasjen sipas kërkesës sonë. Nga dokumentet të cilat i kemi pranuar në qasjen në dokumente zyrtare konstatohet se AK ka rekomanduar për kontratë OE të papërgjegjshëm. Grupi i OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kriterin nr.1 dhe nr.2 lidhur me kapacitetin teknik & profesional si në kërkesat e parashtruara nga AK në nenin 9.1&9.2 të FDT-se.

Kapaciteti teknik dhe profesional, Dëshmia e kërkuar dokumentare: 3.Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjte apo të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit ( nga data e publikimit të njoftimit për kontratë) jo me pak se 30.000.00€.

Dëshmia 3. Një listë në original të kontratave të përfunduara për furnizim të ngjashme të realizuara në periudhën e shkuar tri vjeçare. Lista duhet të jetë afërsisht e njëjtë me Aneksin Nr. 7. duke saktësuar furnizimet e përfshira, shumën e kontratës, datën e pranuesit; (i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër apo partner biznesi, për dëshmi të këtij livrimi shërbejnë kopje të certifikatave (certifikata, raporte pranimi, referenca) të rëndësishme të lëshuara ose të bashkë-nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur shërbimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i furnizimit të tillë. 4.Operatori Ekonomik duhet të ofrojë Katalog nga prodhuesi ne harmoni me specifikimet teknike te përcaktuar ne Aneksin 1 te dosjes se tenderit.

Katalogu nga prodhuesi për te gjithë artikujt e specifikuar ne aneksin 1 te dosjes se tenderit. Sipas listës se kontratave te dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontrate nuk ka ofruar dëshmi te mjaftueshme se për periudhën 12.11.2021-12.11.2024. ka realizuar furnizime te ngjashme ne vlerën 30,000.00euro. Për kontratën nr 1 ne liste OE ka dorëzuar dëshmi referencën mirëpo kohëzgjatja e kontratës ka qene për periudhën 30.12.2020-29.12.2021. AK është dashur te kërkojë sqarime shtese nga OE se sa është vlera e realizuar e kësaj kontrate për periudhën 12.11.2021. deri me 29.12.2021. Pak e besueshme është qe furnizimet për kontratën kornize 3vite janë realizuar brenda periudhës me pak se 45dite e cila e përfshin periudhën 3vite nga publikimi i njoftimit për kontrate për projektin ne fjale. AK/ komisioni vlerësues është dashur qe lidhur me këtë kontrate te kërkojë sqarime shtese faturat & flet dërgesat dhe dëshmi tjera për pranim-dorëzimin e mallit si dëshmi shtese për te plotësuar kriterin nr.1 lidhur me kapacitetin teknik & profesional. Pasiqe kontrata është e lidhur me KK Prishtine AK ka mund te verifikojë kohen e realizimit te projektit fare pa komunikuar me OE. Ne rast se furnizimet e realizuara për këtë kontrate kane qene jashtë periudhës 12.11.2021 - 29.12.2021 nuk mund te pranohet referenca si dëshmi valide pasiqe koha e realizimit nuk përfshin periudhën 3vite nga publikimi i njoftimit për kontrate, për kontratat me nr 2,3,4 te cekura ne liste nuk mund te merren si valide dëshmitë pasiqe janë jashtë periudhës 3vitet e fundit nga publikimi i njoftimit për kontrate ne këtë aktivitet. Referenca për kontratën nr 5 ne liste ne vlere 4846euro është e pranueshme ndërsa për kontratat me nr rendor 6, 7, 8, 9 OE ka dorëzuar vetëm kontratat scan dhe nuk ka ofruar me shume dëshmi se furnizimet/ kontratat janë realizuar me sukses. Pra OE ka dorëzuar vetëm një reference valide ajo e lëshuar nga shërbimi korrektues ne vlere 4846.00. OE Office trade ka tentuar te veje ne lajthitje AK/komisionin vlerësues duke bashkangjitur te dhëna jo valide, fatura & flet dërgesa dhe kontrata te realizuara me KK Prizren ne vitin 2020.

Përveç fakteve te lartcekura Grupi i OE ne fjale janë te papërgjegjshëm poashtu pasiqe ne Aneks 5 Deklaratën për themelimin e grupit ka përcaktuar lider kompaninë NTSH Office trade ndërsa ne e-prokurim lider ka përcaktuar Europrint Group sh.p.k. kompleksi Banesor A1 Lagja Emshir Prishtinë, 10000, Prishtinë, Kosovë prandaj duke mare për baze se OE ka dhënë te dhëna kontradiktore është dashur te eliminohet automatikisht nga procedura e tenderit. Grupi i OE Europrint Group sh.p.k. & Arbnora Zabeli Aliu poashtu janë te papërgjegjshëm pasiqe nuk kane plotësuar kriterin nr.2 lidhur me kapacitetin teknik & profesional pasiqe nuk kane dorëzuar katalogun nga prodhuesi për artikujt e ofruar. Grupi i OE ka dorëzuar katalogun e produkteve nga prodhuesi Jiangsu Lion Sports Goods Co.,Ltd.

Siç shihet ne katalog dhe linkun <https://jiangsulionsports.manufacturer.globalsources.com/homepage> ky prodhues meret me prodhimin e e peshave të kyçit të këmbës, rrotullave me shkumë, dyshekëve joga, rripave për

tërheqje, kettlebells dhe produkte te ngjashme.

OE nuk ka dorëzuar katalog autentik nga prodhuesi por ka përdorur emrin e këtij prodhuesi dhe ka paraqitur produktet me poshtë si prodhime nga ky prodhues. Kjo kompani nuk bën prodhimin e produkteve për pozicionet 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10.

AK për pozicionet 4, 5, 6, 9, 10 ka kërkuar produkte të aprovuara nga federatat përkatëse, brendet Spalding, Molten, Kettler, Elan etj. OE ka ofertuar me produkte no name të cilat kanë kosto shume me të ulët, edhe nga çmimet e ofruara shihet se grupi i OE nuk ka ofertuar produkte cilësore të cilat janë kërkuar nga AK si në Aneks 1 të dosjes së tenderit. Për të verifikuar këtë çështje në kemi kontaktuar nëpërmjet emailit prodhuesin JiangSu Lion Sports duke i kërkuar katalogun gjeneral të produkteve të cilat janë prodhim i tyre dhe me 16.01. kemi pranuar përgjigje katalogun e produkteve nga ky prodhues i cili nuk përkon me katalogun të cilin OE ka dorëzuar në ofertim, edhe në faqen eëë.jslionsports.com shihet se ky prodhues nuk bën prodhimin e produkteve me nr rendor 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10. Prandaj me këtë prove faktojmë se OE ka përgatitur katalog me foto dhe përshkrime por ky dokument nuk është autentik nga prodhuesi në këtë mënyrë OE nuk plotëson kriterin nr.2 lidhur me kapacitetin teknik&profesional. Bashkangjitur me ankese gjeni korrespondencat me prodhuesin dhe katalogun gjeneral të produkteve.

OE në katalog në shume pozicione nuk ka paraqitur të dhëna lidhur me specifikimet teknike dhe brendin por vetëm ka vendosur foto të produkteve të nxjerra nga interneti, prandaj AK/komisioni vlerësues është dashur që të na trajtoje barabarte të gjithë OE ofertues në këtë procedure tenderimi dhe vlerësimi i ofertave të bëhet në harmoni me kriteret dhe kushtet e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit. Më parasysh faktet e lartcekura konstatojmë se AK/komisioni vlerësues ka rekomanduar për kontratë jashtëligjshëm grupin e OE të papërgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit i cili nuk plotëson kriteret e parashtruara lidhur me kapacitetin teknik&profesional.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur në neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 21/01/2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0049/2025, i cili është dorëzuar me datë 29/01/2025.

*Lidhur me pretendimet e OE "AWA SH.P.K." ekspertja shqyrtuese përmes raportit nr. 2025/0049 ka vlerësuar si në vijim:*

OE ankues në ankese e kundërshton ofertën e operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës në procedurën e prokurimit: "Pajisje Rekuizita Sportive", me nr. të prok: 616-24-11629-1-2-1, dhe pretendon se nuk janë prezantuar projekte të realizuara ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Eksperti shqyrtues sqaron se AK – Komuna Prishtine për këtë procedurë të prokurimit në kërkesën nr. 3 tek Kapaciteti Teknik dhe Profesional është kërkuar: 3.Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratë të natyrës së njëjtte apo të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit ( nga data e

publikimit te njoftimit për kontrate) jo me pak se 30.000.00 €. Dëshmia: 3. Një listë në origjinal të kontratave të përfunduara për furnizim të ngjashme të realizuara në periudhën e shkuar tri vjeçare. Lista duhet të jetë afërsisht e njëjtë me Aneksin Nr. 7. duke saktësuar furnizimet e përfshira, shumën e kontratës, datën e pranuesit; (i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër apo partner biznesi, për dëshmi të këtij livrimi shërbejnë kopje të certifikatave (certifikata, raporte pranimi, referenca) të rëndësishme të lëshuara ose të bashkë-nënshkuara nga autoriteti i tillë; (ii) kur shërbimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i furnizimit të tillë.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i propozuar për dhënien e kontratës ne oferte ka prezantuar listën e projekteve te realizuara sipas kërkesës se AK-se, dhe vlerës se përcaktuar. OE ankues ne ankese kërkon qe te bëhen ndarja dhe te merren për baze vlerat e realizuara vetëm për periudhën kohore te përcaktuar nga AK, nga dt. 12.11.2021 deri me datën 12.11.2024, megjithatë, eksperti shqyrtues sqaron se KRPP ne faqen e saje ka te publikuar sqarimin lidhur me pretendimin tillë. Ne pyetjen e datës 10. 22.11.2022 - Kurdo që kërkohet në FDT të Dosjes së Tenderit dhe në Njoftim për Kontratë "Lista e kontratave të realizuara (përfunduara) në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë", gjatë vlerësimit të tenderëve, a duhet të merret për bazë totali i vlerës së kontratës apo duhet të përpjesëtohet?

KRPP ka dhënë këtë sqarim: Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP ofron interpretimin ligjor si në vijim: Sa i përket dëshmime të kërkuara nga Autoritetet kontraktuese në FTD të Dosjes së tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë në lidhje me Aftësitë teknike dhe/ose profesionale.... Pra për bazë duhet të merret periudha e përfundimit jo e fillimit të kontratës. Për më shumë, kjo do të thotë se në këtë listë duhet të saktësohen të gjitha informatat e hijezuara në këtë nën-paragraf: Llojin e shërbimeve, shumën e kontratës që nënkupton totalin e përgjithshëm të kontratës, datën dhe pranuesin. Si rrjedhojë, gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve në përputhje me dispozitën e lart cituar duhet të merret për bazë shuma totale e kontratës së specifikuar në listë dhe jo të përpjesëtohet...”, prandaj, këtë pretendim ankimor e vlerësojmë si te pa bazuar. Lidhur me pretendimin tjetër ankimor, eksperti shqyrtues sqaron se Grupi i OE-ve ankues ne oferte ka dorëzuar marrëveshjen e krijimit te grupit konzorciumit e cila i plotëson kushtet ligjore te përcaktuara me nenin 71 te LPP-se dhe nenit 26 te Rregullores me nr. 001/2022, për Prokurim Publik, gjegjësisht, sipas formularit te dorëzimit te tenderit si partner nr. 1 apo lider i grupit rezulton te jete OE Office Trade – Arbnora Zabeli, ashtu siç është deklaruar edhe ne deklaratën e krijimit te grupit, prandaj edhe ky pretendim ankimore është i pa bazuar.

Pretendimi tjetër ka te beje me kërkesën nr. 4, te Kapacitetit Teknik dhe Profesional, ku AK ka kërkuar në kërkuar ne dosje te tenderit dhe ne njoftimin për kontratë: 4. “Operatori Ekonomik duhet të ofrojë Katalog nga prodhuesi ne harmoni me specifikimet teknike te përcaktuar ne Aneksin 1 te dosjes se tenderit”. Dëshmia: “Katalogu nga prodhuesi për te gjithë artikujt e specifikuar ne aneksin 1 te dosjes se tenderit”. Eksperti shqyrtues sqaron se OE i propozuar për dhënien e kontratës ka prezantuar ne oferte katalogun e prodhuesit “Jiangsu Lion Sports Goods Co.,Ltd, ku ne te njëjtin katalog janë te prezantuara te gjitha produktet e aplikuara nga AK – Komuna Prishtine ne aneksin 1 te dosjes se tenderit dhe ne paramase, prandaj edhe këtë pretendim ankimor e vlerësojmë si te pa bazuar.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët procedurale përmes sistemit të e-prokurimit ku autoriteti kontraktues është pajtuar me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës ndërkaq operatori ekonomik nuk është pajtuar për mendimin e dhënë të ekspertit shqyrtues.

-Gjetjet e Panelit Shqyrtues-

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE "AWA" SH.P.K ".Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Raporti i ekspertit shqyrtues ka vlersuar se pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE "AWA" SH.P.K, janë të pa bazuara.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë të pa bazuara, të paraqitura ndaj Vendimit të autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimit dhe rekomandimit në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave,

konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e operatorit ekonomik duhet refuzohet si e pabazuar dhe mbet në fuqi, Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, i dates, 24.12.2025, për shpërblim me kontratë operatorin ekonomik GOE"Euoprint Group; Arbnora Zabeli Aliu".

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar, Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Paisje Rekuizita Sportive" me numër prokurimit; 616-24-11629-1-2-1, Komuna e Prishtinës.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportet e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet vlersimet e ekspertit shqyrtues me rekomandim, të cilët kanë shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij me numër; 2025/0049, se gjatë zhvillimit të kësaj procedurë të prokurimit, autoriteti kontraktues ka zbatuar dispozitat ligjore të LPP-së.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj" lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e refuzimit të ankesës të OE "AWA" SH.P.K vendosi ti konfiskoj tarifën e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP, ndërsa mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, Paneli Shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi







Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Isa Hasani**

*Hasani*

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - AWA SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: